



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER AIDA E. SHAMETI
ADRESA NR.9, ASIM VOKSHI, NR.36
TEL:**

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 966

Nr. koleksioni: 306

Tirane më 10/05/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29-07-1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, datë 10-03-2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20-12-2018 "Për Notarinë" i ndryshuar



A2022051030031841219

REF ID: A65511
NOV 1964
TIRA



KONTRATË SHITJE KUOTE E PJESE KUOTE

(TË SHOQËRISË ""PRIME- DISTRIBUTOR SH.P.K)

Sot, më datë 10 Maj 2022 para meje **Notere AIDA E. SHAMETI**, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.9, ASIM VOKSHI, NR.36, u paraqit personalisht:

SHITES: FRANC KAÇORI, atësia Bardhul, amësia Ingrida, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Barikata; Nd. 131; H. 1; Ap. 9; Njësia Administrative Nr. 9; Njesia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 22/04/1993, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036698909 dhe nr. personal J30422074I, **me cilesine e Ortakut** ne Shoqerine "PRIME DISTRIBUTOR" Shpk, regjistruar date 10. 12. 2020, me NIPT M02410009M, me Seli ne Tirane, Rruga "Mine Peza", Zona Kadastrale 8330, Nr. pasurie 7/168, prane Hotel "Eurostar", Tirane.

SHITES: XHULJANA MJEKRA, atësia Kujtim, amësia Vjollcë, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në TIRANË, me adresë Asim Vokshi; Nd. 14; H. 53; Ap. 46; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 16/01/1993, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036808297 dhe nr. personal J35116050C, **me cilesine e Ortakut** ne Shoqerine "PRIME DISTRIBUTOR" Shpk, regjistruar date 10. 12. 2020, me NIPT M02410009M, me Seli ne Tirane, Rruga "Mine Peza", Zona Kadastrale 8330, Nr. pasurie 7/168, prane Hotel "Eurostar", Tirane.

BLERES: ELVIS MUÇOLLARI, atësia Agim, amësia Lumturi, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në TIRANË, me adresë Isuf Elezi; Nd. 1; H. 15; Ap. 26; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 25/06/1986, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032708992 dhe nr. personal I60625069S, .

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotes së kapitalit të Shoqërisë ""PRIME DISTRIBUTOR" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

Sipas ekstraktit të datës 10. 05.2022 të nxjerrë nga të dhënat që përmban regjistri tregtar i administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit rezulton se Shoqëria tregtare "PRIME DISTRIBUTOR" Sh.p.k, është regjistruar në datën 10. 12. 2020, me seli në adresën Rruga "Mine Peza", Zona Kadastrale 8330, Nr pasurie 7/168, pranë Hotel "Eurostar", Tirane, dhe përbëhet nga 2 kuota me vlerë totale kapitali prej 100.000 (njëqind mijë) lekë, të cilat janë në pronësi të **Xhuljana Mjekra (51.000 leke); dhe Franc Kaçori (49.000 leke).**

Unë noterja, me autoritetin që më jep ligji, në përputhje me vullnetin e palëve, në përputhje me parashikimet e dispozitave të ligjit Ligj nr. 110/2018 dt. 28.12.2018 "Për Noterinë", në përputhje me parashikimet e neneve 705 e vijues të Kodit Civil, i ndryshuar, në përputhje me parashikimet e neneve 12, 73 dhe 74 të Ligjit nr. 9901, datë 14. 04. 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtarët", të ndryshuar, si dhe në përputhje me dispozitat e akteve të tjera ligjore e nën ligjore në fuqi, pasi shqyrtova dokumentacionin identifikues të personave që kërkuan lidhjen e kësaj kontrate, Vendimin e Asamblesë së Ortakeve Nr. 4 datë 10.05.2022 i cili miraton shitjen e një pjese te kuotës se **Xhuljana Mjekra** me vlerë të kapitalit 1000 leke, e pjesëmarrje ne përqindje 1 %, të Shoqërisë "PRIME DISTRIBUTOR" Sh.p.k., përkatësisht 1 % (një përqind), ne vlerën 1000 (një mijë) leke nga shitësi Xhuljana Mjekra tek blerësi Elvis Muçollari, dhe shitjen e kuotës se **Franc Kaçori** me vlerë të kapitalit 49000 leke, e pjesëmarrje ne përqindje 49 %, të Shoqërisë "PRIME DISTRIBUTOR"



A2022051030031841219

Sh.p.k., përkatësisht 49 % (dyzet e nëntë përqind), në vlerën 49000 (dyzet e nëntë mijë) leke nga shitësi Franc Kaçori tek blerësi Elvis Muçollari.

Pasi shqyrtova edhe dokumentacionin tjetër të paraqitur prej tyre lidhur me objektin e shitjes, duke konstatuar përputhjen e vullnetit të tyre të lirë e të pavesuar edhe me parashikimet e legjislacionit në fuqi, redaktoj këtë kontratë me kushte, afate dhe të drejta e detyrime si më poshtë.

Objekti

Kjo kontratë ka për objekt shitjen e një pjese të kuotës (pjesës), që sipas ekstraktit historik të QKB bashkëlidhur, dhe sipas specifikimeve më sipër, Xhuljana Mjekra, me cilësinë e ortakut, zotëron në Shoqërinë "PRIME DISTRIBUTOR" sh.p.k, dhe shitjen e kuotës që sipas ekstraktit historik të QKB bashkëlidhur, dhe sipas specifikimeve më sipër, Franc Kaçori, me cilësinë e ortakut, zotëron në Shoqërinë "PRIME DISTRIBUTOR" sh.p.k.

MEQËNËSE:

Shitësi Franc Kaçori zotëron me të drejta të plota kuotën e Shoqërisë "PRIME DISTRIBUTOR" shpk me vlerë kapitali 49.000 lek, të barabartë me 49% të kapitalit të shoqërisë e barabartë me 1 kuotë, ndërsa shitësi Xhuljana Mjekra zotëron me të drejta të plota pjesën e kuotës në Shoqërinë "PRIME DISTRIBUTOR" shpk me vlerë kapitali 1000 lek, të barabartë me vlerë e përqindje në kapitalin e Shoqërisë 1% të kapitalit të shoqërisë.

Blerësi dëshiron të blejë një pjese të Kuotës së Shitësit Xhuljana Mjekra (me poshtë quajtur "Kuota e Kapitalit në Shitje"), prej 1 %, me vlerë e përqindje në kapitalin e Shoqërisë, me vlerë 1000 (një mijë) leke të identifikuar me sipër dhe të gjitha të drejtat e detyrimet që lidhen me të.

Blerësi dëshiron të blejë Kuotën e Shitësit Franc Kaçori (me poshtë quajtur "Kuota e Kapitalit në Shitje"), prej 49 %, me vlerë 49000 (dyzet e nëntë mijë) leke në kapitalin e Shoqërisë, të identifikuar me sipër dhe të gjitha të drejtat e detyrimet që lidhen me të.

NE KUADËR TE KUSHTEVE PARAPRAKE TE MËSIPËRME, Shitësi dhe Blerësi, bien dakord të nënshkruajnë këtë Kontratë sipas kushteve dhe termave të mëposhtme:

Shitësi dhe Blerësi *këtu e me poshtë në këtë Kontratë, se bashku do të referohen si "Palet/ve"*.

Kushtet paraprake janë pjese integrale të kësaj Kontrate dhe përcaktojnë qëllimin e Palëve në lidhjen e saj.

Duke patur parasysh sa më lart Palet bien dakord për sa vijon:

Neni 1

Shitja dhe transferimi i pronësise

Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Shitësit i shesin Blerësit dhe Blerësi blen nga Shitësit përkatësisht 50 % (pesëdhjete) si dhe çdo të drejtë e detyrimi të lidhur me të ose që rrjedh prej saj .

Blerësi do të bëhet pronar me të drejta të plota mbi Kuotën e Kapitalit në Shitje dhe të drejtat e detyrimet që lidhen me të ose rrjedhin prej saj, përfshirë të drejtën e votës dhe të dividendit.

Neni 2

Çmimi i shitjes

Blerësi bie dakord t'i paguajë Shitësave për Kuotën e Kapitalit në Shitje (50 %), çmimin në shumën 50.000 (pesëdhjete mijë) Leke (referuar kudo në këtë Kontratë si "Çmimi i Shitjes").

Neni 3

Deklarime dhe garanci



Shitësi deklaron dhe garanton se ka të drejtë dhe nuk ka asnjë pengesë të çfarëdo natyre që të lidhë dhe zbatojë këtë Kontratë dhe se kjo Kontratë përbën detyrim ligjor, të vlefshëm, të detyrueshëm për Shitësin. Kuota e Kapitalit në total (pjesa 50%) në Shitje objekt i kësaj Kontrate i shitet Blerësit në gjendjen në të cilën është dhe me të drejtat që lidhen me të ose rrjedhin prej saj.

- Blerësi deklaron dhe garanton se ka të drejtë dhe nuk ka asnjë pengesë të çfarëdo natyre që të lidhë dhe zbatojë këtë Kontratë. Gjithashtu, Blerësi e pranon Kuoten e Kapitalit në Shitje (50 %) objekt i kësaj Kontrate në gjendjen në të cilën është dhe nuk ka asnjë pretendim në lidhje me të apo të drejta që lidhen me të ose rrjedhin prej saj.
- Blerësi garanton Shitësin se paratë për pagimin e Çmimit të Shitjes nuk burojnë nga asnjë aktivitet i kundërligjshëm.
- Kuota (pjesa 50 %) që i transferohet Blerësit do të jetë e lirë nga cdo peng, barrë, detyrime, kufizime, apo pretendime nga të tretë.
- Shitësi deklaron se Shoqëria është themeluar rregullisht dhe nuk rezultojnë shkaqe që mund të cojnë në pavlefshmërinë apo anulimin e akteve dhe të themelimit të saj
- Shitësi deklaron se Shoqëria nuk ndodhet në gjendje falimentimi, likuidimi, administrimi të kontrolluar, apo procedua të ngjashme apo të njëjta me to dhe nuk subjekt i procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm.
- Shitësi ka titull të vlefshëm pronësie dhe të drejta të plota mbi kuotën
- Kuota është e lirë nga pengje, kufizime, barrë detyrime nga të tretë.
- Shitësi do të mbajë përgjegjësi ekzkluzive për cdo dëm, humbje, kosto, shpenzim apo për veprime apo mosveprime për periudhën deri në datën e kalimit të shitjes.

Neni 4 **Gjuha e kontratës**

Kjo kontratë redaktohet në 4 ekzemplarë me vlerë të njëjtë në gjuhën shqipe.

Neni 5 **Regjistrimi i kontratës**

Palët kanë detyrimin që një kopje të kësaj kontrate ta depozitojnë menjëherë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Me regjistrimin e kontratës blerësi Elvis MUÇOLLARI, behet pronar i 50 % (pjesëmarrja në përqindje) e kapitalit në Shoqërinë "PRIME DISTRIBUTOR" Shpk, me vlerë kapitali në shoqëri 50.000 (njëqind mije) lekë.

Neni 6 **Ligji zbatues dhe zgjidhja e mosmarrveshjeve**

Për çështje të cilat nuk janë parashikuar në këtë Kontratë apo që mund të rrjedhin prej saj do të zbatohet legjislacioni përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë i cili është ligji i zbatueshëm për këtë Kontratë. Çdo mosmarrveshje që mund të lindë midis Palëve të kësaj Kontrate në lidhje me zbatimin apo interpretimin e kësaj Kontrate, nëse nuk zgjidhet në mirëkuptim mes vetë Palëve, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 7 **Te ndryshme**



Secila prej Palëve do të përballojë shpenzimet e veta në lidhje me negocimin, nënshkrimin dhe përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë.

Kjo Kontratë përgatitet dhe nënshkruhet në katër origjinale me vlerë të njëjtë secili dhe ky akt përbën ëë gjithë marrëveshjen e arritur midis Palëve, premtimet, deklaratimet, garancite në lidhje me objektin e kësaj Kontrate.

Asnjë ndryshim i kësaj Kontrate nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk bëhet me shkrim dhe nënshkruhet personalisht nga Palët e kësaj Kontrate apo përfaqësues të autorizuar rregullisht prej secilës nga Palët në kontratë.

Neni 8

Veprime të noterit për përfundimin e procesit të lidhjes së kontratës

Pas redaktimit të kontratës, në përputhje me Ligjin nr. 110/2018 dt. 28.12.2018 "Për Noterinë", me qëllim përfundimin e procesit të lidhjes së kontratës, nga unë Noterja u kryen veprimet e mëposhtme:

- Teksti i kontratës u hartua në një dokument me 4 faqe, në katër ekzemplarë origjinale, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlerë ligjore të njëjtë, nga të cilat një ekzemplar ruhet në arkivin e Noteres dhe katër të tjerë u dorëzohen përkatësisht je shitësit dhe tre blerësit.
- Kontrata iu lexua palëve të cilat e kuptojnë, e pranojnë përmbajtjen e tekstit, duke e gjetur atë në përputhje me vullnetin e tyre dhe e nënshkruajnë pa vërejtje, duke vënë emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin në përputhje me parashikimet e nenit 62 të 110/2018 dt. 28.12.2018 "Për Noterinë".
- Palët u këshilluan që në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14. 04. 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe të Ligji nr. 9723, datë 03. 05. 2007 "Për regjistrimin e biznesit", të regjistrojnë kalimin e pronësisë sipas kësaj kontrate në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- Unë Noterja, me autoritetin që më jep ligji Nr. 110/2018 dt. 28.12.2018 "Për Noterinë", në përputhje të plotë me dispozitat e tij, pas kryerjes së veprimeve të mësipërme, vërtetoj shprehjen e vullnetit të plotë e të pavesuar të palëve, të pasqyruar në tekstin e kësaj kontrate redaktuar saktësisht sipas kërkesës së tyre dhe nënshkrimin nga palët e kësaj kontrate në praninë time.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITES: Franc Kaçori

Franc Kaçori

BLERES: Elvis Muçollari

Elvis Muçollari

Xhuljana Mjekra

Xhuljana Mjekra

NOTERE: AIDA E. SHAMETI

(Large signature)

